

VENDIM
Nr. 753, datë 26.10.2016

**PËR NJË RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2016, MIRATUAR
PËR MINISTRINË E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË
UJËRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 17, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Programit buxhetor “Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit”, i shtohen 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë, shpenzime korrente, për financimin e Urdhrit të Mjekut Veterinar.
 2. Programit buxhetor “Zhvillimi rural duke mbështetur bujqësinë, blegtorinë, agroindustrinë dhe marketingun”, i pakësohen 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë, shpenzime korrente, nga skema mbështetëse për bujqësinë.
 3. Ngarkohen ministri i Financave dhe ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi